



Bazuar në Ligjin Nr. 08/L – 197 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës dhe Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, Rregulloren nr. 05/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me datë 17 Prill 2025 publikon këtë:

NJOFTIM

Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 29/01/2025 ka shpallur konkursin me nr. reference RN00016519 për pozitën ZYRTAR PËR KADASTËR në Divizionin e Zyrës Rajonale Prizren.

Pas përfundimit të procedurës së verifikimit paraprak, vetëm një (1) kandidat ka kaluar në fazën e testimit me shkrim. Në testimin me shkrim ka marrë pjesë vetëm një kandidat. Pas vlerësimit të testimit me shkrim nga ana e Komisionit të Pranimit, ka rezultuar që kandidati e ka kaluar pragun minimal të pikëve dhe ka kaluar në fazën e vlerësimit përmes intervistës. Pas njoftimit dhe ftesës për pjesëmarrje në intervistë me gojë, kandidati nuk është paraqitur në intervistë.

Si rrjedhojë, procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar Kadastral me Nr. Ref. RN00016519 vlerësohet si e dështuar.

Andaj, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit njofton se procedura e rekrutimit me nr. reference RN00016519 për pozitën ZYRTAR PËR KADASTËR në Divizionin e Zyrës Rajonale Prizren dështon, dhe së shpejti do të shpallet procedurë e re e rekrutimit.

Këshillë juridike: Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Prishtinë, 17 Prill 2025


Fatos Meqa
Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore
Agjencia Kosovare e Privatizimit